



|                                                                                     |                                        |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                                        |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                        |
| Dep.<br>Dep. <u>2.D/DPK</u>                                                         | Nr Prot.<br>Br Prot. <u>01-4810/15</u> |
| Nr. i faq.<br>Broj stranica <u>02</u>                                               | Data<br>Datum <u>17-12-2015</u>        |
| PRISHTINE                                                                           |                                        |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.12.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3975/15, për zyrtarin e lartë z. Rifat Mazreku, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3975/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Rifat Mazreku, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Rifat Mazreku, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës.

Gjatë kontrollit është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privat dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 13.11.2015, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Rifat Mazreku, ka ardhur në zyrat e AKK-së ku nga zyrtaret kompetent të ngarkuar me rastin është njoftuar me faktet dhe provat që posedon AKK-ja

Zyrtari i lartë z. Rifat Mazreku, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pas njohuri lidhur me situatën e konfliktit të interesit, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veprojë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Me datën 11.12.2015 kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Rifat Mazrekaj, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin N.T.SH "ERIDEN me numër 70882736.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Rifat Mazreku, Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës, duke bërë ndryshimet në biznesin privat, dhe duke hequr dorë nga ushtrimi i pozitës së personit të autorizuar në biznesin e tij, janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

